



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë /a/e:</b>	06-01-2020
<b>Referencë:</b>	07-353/04-2126/20
<b>Për / Za/ To:</b>	Ngadhnim Dibrani
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Qendrës për shërbim me qytetarë
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Kontrolloi:</b>	Habib Qorri
<b>Punoi:</b>	Sabri Gashi
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, ka pranuar kërkesën e Ngadhnim Dibrani, për shfrytëzimin e hapësirës publike vendosjen e stendës lëvizëse 1.00 m<sup>2</sup> për kërkim të mjeteve për shërim të koleges studente Nora Saraqi e cila lëngon nga Leukemia. Qëllimi i kërkesës është humanitar mbledhje të fondeve për shërim. Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, nën shkronja g), i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, nr.01-110-157481, i jep

#### Pëlqimin

Ngadhnim Dibrani ka kërkuar shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin "Zahir Pajaziti", para Hotel Grandit.

Shfrytëzimi i hapësirës ka të bëjë me organizimin e aktivitetit nga studenten për grumbullim të fondeve për kolegen e sëmur.

Organizimi i aktivitetit lejohet të mbahet nga 07.01.2020 deri me 10.01.2020.

Për vendosjen e stendës jeni të obliguar të ruani pllakat, të vendosni në qoshe duke mos penguar qasjen e qytetarëve.

Organizatori obligohet që:

- të mos përdorë zerim gjatë aktivitetit,
- të kujdesen mirë që punimi të mos të paraqesë rrezik për qytetarë që lëvizin në këtë pjesë,
- pas përfundimit të afatit të largohet shtandin nga hapësira e shfrytëzuar.

Po ashtu, nëse kërkohet ndonjë urgjencë nga Komuna, hapësira duhet të lirohet në afat kohor të cilin e kërkon Komuna.